



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/87 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 82

Data/Datum/Date 26 / 01 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.1.2026, merr këtë:

### V E N D I M

#### **Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 01 Nr. 31/25, i datës 28.3.2025, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin me Nr. Prot. 01 Nr. 50/25, i datës 29.4.2025.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
  - 2.1. **Nora Boshnjaku**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
  - 2.2. **Altin Zhuniqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
  - 2.3. **Dafina Gashi**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - AAK;
  - 2.4. **Mirsad Shehu**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - PDK;
  - 2.5. **Nazmi Bellaqa**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, janë: shpallja e njoftimit publik për shprehjen e interesit, i cili përfshin: emrin; përshkrimin; sipërfaqen; destinimin dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim; afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës; veprimtarinë që mund të ushtrohet; afatin e fundit për aplikim; vendin ku bëhet pranimi i ofertave për shprehje të interesit, si dhe informacionet shtesë.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe dispozitat e Rregullores

(QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 32/25, i datës 28.3.2025, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin me Nr. Prot. 01 Nr. 49/25, të datës 29.4.2025.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr. 87/26**  
**Datë: 26.1.2026**

  
**Fatmir Iska**  
**Kryesues i Kuvendit**